



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE
DREJTORIA TEKNIKE

RELACION
Mbi
Hapjen e ankandit publik të njësive të shërbimit të Banesës në Fier
me 35 apartamente dhe 6 njësi shërbimi.

Pershkrimi

Ne qytetin e Fierit është ndërtuar me fondet e EKB-së një banesë me 35 apartamente dhe një kat lokale shërbimi në katin përdhe.

Objekti është ndërtuar në Lagjen "16 Prilli", Rruga "Kujtim Ajaci "Zona kadastrale 3934 me Nr.pasurie 60/162 Fier, në një zonë e cila është e formuluar me ndërtime të reja, dhe një pozicion të favorshëm në raport me rrugën.

Ekzistenca e Lokaleve në katin përdhe ka përcaktuar vijën e ndërtimit dhe e ka bërë më urbane dhe me njerëzore pjesën e rrugës duke i dhënë kësaj një dimension tregëtar që është mjaft i nevojshëm për zonën.

Arkitektura e objektit Banesë tip 83/5 8 kate është e thjeshtë, një arkitekture banimi me një fasadë me suva dhe bojë plastike. Banesa është e paisur me ashensor.

Kati përdhe është projektuar me 6 njësi shërbimi, punimet kanë përfunduar plotësisht. Jane përfunduar te gjitha punimet e rifinitures, si shtresat, suvatimet dhe bojatisja, dyer ,vetrata, eshte kompletuar edhe ambienti i tualetit me paisjet hidro sanitare. Punimet e kryera jane te nje cilesie te mire.

Dyshemeja e katit përdhe është e hidroizoluar me dy shtresa guajn dhe e shtruar me pllaka qeramike cilesi e pare.

Eshte realizuar rrjeti rrufeprites, togezimi .

Për katin përdhe lokal shërbimi janë realizuar hyrjet e daljet me rampa te veçanta .

Shkallët janë veshur me pllaka mermeri.

Objekti ka këto kondicione urbane:

Lartësia e përgjithshme e godines është 28.34 meter
Numri i kateve 8,
Distanca e volumit nga aksi i rruges është 15 m
Distanca e volumit nga rruga është 8 m
Sipërfaqe e ndertimit (Truall+ Trotuar) është 416 m²
Nr.i njesive te shërbimit është 6

Ambjenti përreth objektit deri ne lidhjen me rrugen është i sistemuar

Objekti është i lidhur me infrastrukturen inxhinierike FU, FEE, KUZ.

Te dhenat mbi sipërfaqen e lokaleve ne katin përdhe

Kati përdhe ka nje sipërfaqe ne total 401,45 m²
Nga keto 40,46 m² është sipërfaqe e përbashket qe do te përdoret nga katet e sipërme te apartamenteve

Përshkrimi i katit përdhe sipas faktit

Sipërfaqja totale e ndertimit te njesive te shërbimit **360,99 m²**

Sipërfaqet sipas lokaleve

Lokali	Sip.ndertimi m²	
Njesia 1	67,34	
Njesia 2	74,77	
Njesia 3	47,59	
Njesia 4	78,08	
Njesia 5	41,66	
Njesia 6	51,55	
Totali i sip.te ndertimit te lokaleve ne k.përdhe		360,99 m²

Me Vendim te Keshillit Drejtues te EKB-se Nr 40 date 30/06/2014 eshte miratuar çmimi dysheme i hapjes se ankandit publik, per te realizuar shitjen e lokaleve ne katin perdhe ne vleren **56.000 (pesedhjete e gjashte mije) leke / m2 .**

Bashkelidhur ketij informacioni do gjeni:

- 1-Planimetrine e sheshit te ndertimit
- 2- Planimetria e katit perdhe lokal sherbimi.
- 3 – Planimetrite e cdo njesie sherbimi shk.1:100
- 3- Kopje te çertifikatave te pronesise
- 4- Kopje te Vendimit te Keshillit Drejtues te EKB Nr 40, date 30/06/2014

Dokumentacioni i mesiperm sherben per hapjen e ankandit publik te shitjes se Lokaleve ne katin perdhe te baneses tip 83/5, 8 kate me 35 apartamente dhe nje kat lokale sherbimi te ndertuar me fondet e EKB-se ne qytetin e Fierit, Lagjja Zhupan.

Drejtoria Teknike